

**A K T H E M E L I M I d h e S T A T U T**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**HOME STORE ALBANIA SH.P.K**

Sot, në datë 08.09.2023 shtetasja Znj. Engjellushe Veliraj lindur në Vlorë, Shqipëri më 14.04.1963 me nr. Personal identifikimi G35414231E, ka vendosur themelimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar **HOME STORE ALBANIA shpk.**

Ata kanë hartuar, si më poshtë vijon Statutin e Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar.

**Neni 1. Forma**

Ortaku, ka krijuar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, e cila ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanërisht me Ligjin Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” dhe aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë si dhe me dispozitat e këtij Statutit.

Regjimi juridik i shoqërisë mund të ndryshojë me vendim unanim të “ortakëve”.

**Neni 2. Objekti**

Shoqëria ka për objekt:

Agjensi imobiliare, studime tregu, komisione dhe agjensi për të tretet, konsulence dhe ndermjetesim për shitje dhe qeradhenie të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme dhe çdo veprimtari tjetër pa kufizim që ka lidhje me ndermjetesimin kombëtar dhe nderkombëtar të pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme. Shitja dhe ri-shitja, furnizimi i të gjitha produkteve dhe mallrave, qofte me shumice apo pakice i produkteve ushqimore të ndryshme, sallameri, djathëra, vere ... etj

Tregti me Pakice dhe Shumice, Import-eksport, Artikuj Kozmetike, industriale, ushqimore.

Shitje online për produktet që tretojmë.

Aktivitet në fushën e transportit. Kryerja e transportit për llogari të vet dhe /ose të të tjerëve, transport i mallrave dhe i udhëtareve, kombëtare dhe nderkombëtare.

Aktivitet në fushën e ndertimit, hoteleri, restorante, bar-kafë, agjensi turistike, menaxhim turizmi, guida turistike.

  
Engjellushe Veliraj

Me qellim arritjen e objektit te saj, shoqëria me vendim te organit administrativ, mund te zoteroje ne menyre te drejtperdrejte apo te terthorte pjesemarrje ne shoqeri apo ndermarrje te tjera, shqiptare apo te huaja, te cilat kane objekt te njejte, te ngjashem apo ndihmes me te.

### **Neni 3. Emërtimi**

**Emërtimi i shoqërisë është HOME STORE ALBANIA shpk**

Në të gjitha aktet e dokumentet që dalin nga shoqëria, emërtimi i saj do të paraprihet (ose të ndiqet menjëherë) nga inicialet “SH.P.K”

### **Neni 4. Vendodhja e selise**

**Selia e shoqërisë është caktuar në Vlorë, Lagjja: Lef Sallata , Rruga Misto Mele, Objekt privat, ZK Nr 8603, Nr pasurie 24/280, Vol 46, Faqe196.**

Ajo mund të transferohet në cdo vend tjetër të rrethit ose kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë, në bazë të një vendimi të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve. Shoqëria me vendim të asamblesë së ortakëve mund të hapë dhe mbyllë filiale, degë ose zyra përfaqësimi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

### **Neni 5. Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë është caktuar 50 (pesëdhjetë vjet) duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shkurtimi i kësaj kohëzgjatje në rastin e një prishje të përshpejtuar ose zgjatja e afatit bëhen me vendim të Asamblesë së përgjithshme të ortakëve.

### **Neni 6. Përgjegjësia e Shoqërisë**

Shoqëria përgjigjet për detyrimet e saj ndaj të tretëve vetëm me pasurinë e saj. Ortakët e shoqërisë nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë ndaj të tretëve dhe për humbjet e saj, përveçse në masën e vlerës nominale të pjesëve në kapitalin themeltar.

### **Neni 7. Kapitali aksionar**

Kapitali aksionar i nënshkruar është caktuar në vlerën prej 100.000 (njqintëmijë) lekë, pjesëmarrja në përqindje 100% i ndare në 1 (nje ) kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem :

**Znj.Engjellushe Veliraj, pjesëmarrja në përqindje (%) 100%, vlere nominale 100.000 leke.**

Kontributi (kapitali aksionar) i ortakut është në para (lekë).

Ortaku e ka derdhur shumën koresponduese të pjesëve të nënshkruara.

 Engjellushe Veliraj

Personat që nënshkruan këtë akt, pasi kane marrë dijeni për këtë certifikatë, një kopje e së cilës i është paraqitur atij, deklaron se shuma e mësipërme është në përputhje me atë që shënohet në certifikatë dhe se ato konfirmojnë nënshkrimet e pjesëve të kapitalit aksionar në përputhje me shumën respektive të derdhur.

### **Neni 8. Llogaria rrjedhëse**

Ortaku mund ti jap shoqërisë fonde në llogari rrjedhëse. Mënyrat e funksionimit të këtyre llogarive vendosen në cdo rast nga ortakët e shoqërisë.

### **Neni 9. Zmadhimi i kapitalit aksionar**

Kapitali aksionar i shoqërisë mund të zmadhohet sipas modaliteteve dhe mënyrave të parashikuara të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, të ligjit “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Zmadhimi i kapitalit aksionar mund të kryhet vetëm me vendim të Asamblesë së ortakëve, në bazë të raportit të Drejtimit, i cili përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

Asambleja mund t’i delegojë Drejtimit kompetencat e nevojshme për të realizuar zmadhimin e kapitalit.

### **Neni 10. Mënyra e fitimit dhe kalimit të kuotave**

Kuotat (pjesët) e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre, fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë,
- b) shit-blerjes,
- c) trashëgimisë,
- d) dhurimit,
- d) cdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Pjesët e kapitalit mund t’ju transferohen të tretëve vetëm me miratimin e shumicës së ortakëve që zotërojnë mbi 3/4 e pjesëve të kapitalit dhe me kushte jo më të favorshme se ato që i janë ofruar ortakëve.

Cdo ortak që kërkon të tërhiqet nga shoqëria duhet t’a motivojë këtë tërheqje përpara Asamblesë së Ortakëve me anën e kërkesës me shkrim. Ortaku që kërkon të tërhiqet nga shoqëria duhet t’ua ofroje pjesët e tij për blerje ortakeve ekzistues. Kur keta nuk deshirojnë, ka të drejtë t’ua sheshe ato të treta, jo ortake, të cilat duhet të miratohen paraprakisht nga asambleja e ortakeve e cila zbaton të gjitha kërkesat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Emgjëllushë Velisaj

### **Neni 11. Veprimtaria e shoqerise**

Zhvillimi i veprimtarisë së shoqërisë bazohet në parimet ekonomike dhe në respektimin e kërkesave të legjislacionit në fuqi si edhe të rregullave të ushtrimit të aktivitetit privat. Veprimtaria financiare e shoqërisë dhe rezultatet e saj pasqyrohen në llogaritë e shoqërisë dhe në raportin e administratorit.

### **Neni 12. Ushtrimi financiar**

Viti i ushtrimit financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të cdo viti. Përrjashtimisht viti i parë financiar kur do të nis veprimtaria e shoqërisë do të mbyllet më 31 Dhjetor.

### **Neni 13. Inventari. Llogaritë vjetore**

Shoqëria mban një kontabilitet të rregullt në pajtim me ligjin.

Librat kontabël mbahen në gjuhën Shqipe

Shoqëria realizon transaksione në lekë dhe valutë. Konvertimi i llogarive në valutë në fund të vitit bëhet përkatësisht me kursin zyrtar.

Në mbyllje të cdo viti ushtrimi financiar, Drejtimi harton inventarin e elementeve të ndryshëm të aktiveve dhe të detyrimeve në këtë datë si dhe llogaritë vjetore të shoqërisë.

Drejtimi harton raportin vjetor për gjendjen e shoqërisë gjatë vitit të ushtrimit financiar të mbyllur, ndryshimet e ardhshme të parashikueshme, ngjarjet e ndodhura midis datës kur është hartuar raporti dhe veprimet e kërkimit e të zhvillimit.

### **Neni 14. Rezultati, caktimi dhe shpërndarja**

Rezultati i veprimtarisë përcaktohet nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve që i përkasin ushtrimit financiar. Nga fitimet e ushtrimit pasi të jenë zbritur, kur është rasti, humbjet e mëparëshme hiqet te pakten 5% për të krijuar fondet e rezervës statutore. Kur kjo rezervë arrin 1/10 e kapitalit themeltar nuk bëhen më heqje nga fitimet e ushtrimit.

Fitimi i shpërndarë, formohet nga fitimi i ushtrimit duke hequr humbjen e mëparëshme dhe shumat e hequra për rezervat dhe duke shtuar fitimet e pashpërndara të trashëguara.

Emri i Shoqërisë Velizaj

Megjithkëtë, pas heqjes së shumave për t'u kaluar në rezervë në zbatim të ligjit, asambleja e përgjithshme, mund të heq cdo shumë që ajo e gjykon të përshtatshme për të krijuar rezerva të zakonshme ose të jashtëzakonshme ose për të mbartur shumën në ushtrimin e ardhshëm.

Asambleja e përgjithshme mund të vendosë mos vënien në shpërndarje të shumave të fitimeve kur ajo i ri investon në shoqëri, kur ajo ka hua ndaj bankave e institucioneve të kreditimit.

Në qoftë se eventualisht ndonjë ushtrim financiar mbyllet me humbje, shuma e humbjes pas miratimit të llogarive vjetore nga asambleja, mbartet në vitin ushtrimor vijues, për t'u mbuluar nga fitimet e ushtrimeve të ardhshme deri në shuarjen e saj.

### **Neni 15. Organet e Shoqerise**

Organet e shoqërisë janë:

- a) Asambleja e ortakëve,
- b) Administratori.

### **Neni 16. Përbërja e Asamblesë**

Asambleja e ortakëve është autoriteti më i lartë drejtues i shoqërisë. Ajo formohet nga të gjithë ortakët pavaresisht nga numri i pjesëve në kapitalin themeltar që zotërojnë. Sipas natyrës së vendimeve të shoqërisë që është thirrur për të marrë, Asambleja është e zakonshme ose e jashtëzakonshme. Asambletë kryesohen nga një anëtar i zgjedhur nga ortakët. Kryetari i asamblesë emëron një sekretar qoftë dhe jo ortak.

### **Neni 17. Asambleja e përgjithshme**

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë,
- b) ndryshimet në statut,
- c) emrimin e shkarkimin e administratorit,
- d) emrimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
- e) mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- f) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- g) zmadhimin dhe zvoglimin e kapitalit,
- h) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre,

Enqje Kushi Yelinaj

- i) përfaqesimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- j) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë,
- k) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë,
- l) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështje të përcaktuara në shkronjat “f” dhe “g” të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumentave përkatës.

Vendimet e asamblesë së përgjithshme të marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Të regjistrohen në vecanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë,
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve,
- c) investimet,
- d) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë

Vendimet e shoqërisë merren me shumicë të thjeshtë.

### **Neni 18. Administratori**

Shoqëria administrohet nga një Administrator, për një afat 5 (pesë) vjeçar.

**Shoqëria do të administrohet nga Znj.Engjellushe Veliraj me afat 5 (pesë) vjet.**

Administratori emërohet nga Asambleja e Përgjithshme.

### **Neni 19. Përfaqësimi te të tretët**

Në marrëdhënie me të tretët shoqëria përfaqësohet nga administratori.

### **Neni 20. Kompetencat e administratorit**

Administratori ushtron të gjitha kompetencat, të drejtat dhe detyrimet për organizimin dhe drejtimin e shoqërisë, të cilat parashikohen nga ky statut, akti i themelimit dhe legjislacioni shqiptar, për të vepruar në emër dhe për llogari të shoqërisë, në përputhje me objektin e veprimtarisë së saj, me përjashtim të atyre kompetencave që ligji dhe ky statut ja njohin shprehimisht ortakeve.

Kompetencat e administratorit janë:

- Organizimi i veprimtarisë së shoqërisë për të plotësuar programin që buron nga objekti i veprimtarisë së saj.
- Administrimi i përgjithshëm i shoqërisë.

  
Engjellushe Veliraj

- Përfaqëson shoqërinë para autoriteteve gjyqësore, të arbitrimit dhe administrative.
- Administrojnë pasurinë dhe aktivet financiare të shoqërisë brenda kufijëve të caktuar nga ortakët.
- Të lëshojë dokumente zyrtare në emër të shoqërisë për të punësuarit e shoqërisë dhe në përgjithësi për palët e treta.

#### **Neni 21. Ekspertët Kontabël të Autorizuar**

Në rast nevojë ose nëse e kërkon ligji, kontrolli i shoqërisë kryhet nga një ekspert kontabël i autorizuar, i emëruar nga asambleja e ortakëve, duke filluar nga data e emërimit të tyre me mundësi rizgjedhje nga shumica e ortakëve që përfaqësojnë mbi 1/2 e kapitalit themeltar.

Shkarkimi i ekspertit kontabël të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, në rast se vërehen gabime ose bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

#### **Neni 22. Marrëdhëniet e punësimit**

Marrëdhëniet midis shoqërisë, filialeve, degëve ose zyrave të përfaqësimit të saj nga njëra anë dhe të punësuarve nga ana tjetër, rregullohen me kontratën individuale të punës dhe kontratën e shërbimit sipas kërkesave bazë të legjislacionit të punës në fuqi.

#### **Neni 23. Detyrimi për ruajtjen e sekretit**

Ortakët e shoqërisë si dhe cdo person tjetër që asiston në mbledhjen e këtyre organeve duhet të ruajnë fshehtësinë për çeshtjet dhe të dhënat që kanë karakter të brendshëm.

#### **Neni 24. Mënyra e thirrjes**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me postë elektronike duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Në rast se asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsise.

#### **Neni 25. Pjesëmarrja në Asamble**

Cdo ortak, pavarësisht nga numri i pjeseve që zoteron, ka të drejtë të asistojë në mbledhjet e Asamblese të Përgjithshme dhe të marrë pjesë në vendimet e saj, personalisht apo nëpërmjet një

*Enxhela Gushë Yefinqi*

perfaqesuesi. Hyrja ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme behet ne baze te nje dokumenti qe provon identitetin.

### **Neni 26. Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme**

Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara ne ligjin nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, si dhe nga ligje te tjera, ose dispozitat e statutit dhe sa here eshte qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interes te shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Asambleja e pergjithshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

### **Neni 27. Kuorumi, votimi, numerimi i votave**

Në asamblenë e përgjithshme, të zakonshme dhe të jashtëzakonshme, kuorumi llogaritet për tërësinë e pjesëve që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë.

E drejta e votës që ju përket ortakëve është përpjestimore me kapitalin që ato përfaqësojnë.

Cdo pjesë e kapitalit i jep zotëruesit të paktën të drejtën e një vote.

Votimi kryhet me thirrje emerore ose i fshehte.

Votimi kryhet i vecante per cdo ceshtje apo vendim.

### **Neni 28. Venia ne dispozicion te ortakeve te dokumentave dhe informacioneve**


Shoqeria mban dhe ve ne dispozicion te ortakeve ne kushte dhe ne afate te parashikuara nga ligji, raportet, dokumentet dhe llogarite vjetore qe shqyrton asambleja.

Me perjashtim te inventareve dhe te ndonje dokumenti tjeter te caktuar nga asambleja, dokumentet qe duhet t’u vihen ne dispozicion ortakeve u dergohen ketyre bashke me njoftim-thirrjen per mbledhje.

### **Neni 29. Prishja. Likuidimi**

Shoqeria priset:

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj,
- b) me vendim te asamblese se pergjithshme,
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit,
- d) me vendim gjykate.

Enajet  Xelozaj



Përveç rastit të bashkimit ose të ndarjes, prishja e shoqërisë, për çfarë do shkakut qoftë, sjell likuidimin e saj. Likuidimi kryhet nga një ose disa likuidatorë të emëruar nga asambleja e përgjithshme e zakonshme në kushtet e kuoriumit dhe të shumicës për asambletë e zakonshme.

Likuidatori përfaqëson shoqërinë.

Likuidatori mund të kryejë aktet e nevojshme për likuidim dhe, po që se anëtarët nuk kanë parashikuar ndryshe, mund të shesin edhe në bllok pasurinë e shoqërisë dhe të bëjnë marrëveshje e kompromise (shih Kodin Civil).

Likuidatori nuk mund të ndermarre veprime të reja. Në rast të kundërt ata përgjigjen personalisht dhe solidarisht (kur janë më shumë se dy likuidatorë) për punët e filluara (K.C.).

Likuidatori ka kompetencë të plotë për të shitur aktivet e shoqërisë, për të shlyer kreditorët dhe për të shpërndarë mbetjet e disponueshme.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të autorizojë likuidatorin të vazhdojë çështjet në proces ose të ndermarre çështjet të reja për nevojat e likuidimit.

Aktiviteti neto i mbetur ndahet midis ortakëve në përpjestim me pjesëmarrjen e tyre në kapital.

### **Neni 30. Kundershtimet**

Të gjitha kundershtimet, gjatë funksionimit të shoqërisë ose gjatë likuidimit të saj, që lindin midis shoqërisë dhe ortakëve ose midis vetë ortakëve, lidhur me veprimtarinë e shoqërisë, i nënshtrohen juridiksionit të gjykatave kompetente në kushtet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

### **Neni 31. Dispozita të tjera**

Të kryhen të gjitha formalitetet për depozitim në Qendrën Kombëtare të Biznesit të këtij akt-themelimi dhe statut.

Për çështjet që nuk parashikohen në këtë statut të shoqërisë do të zbatohen dispozitat në fuqi të Ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" të Ligjit Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" dhe aktet e tjera ligjore që do të jenë në fuqi gjatë veprimtarisë së shoqërisë.

Vula e shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

Hartuar në Vlorë, më 08 shtator 2023

Në 4 (katër) ekzemplar sa kërkon ligji.

**ORTAKU**

**Engjellushe Veliraj**

Engjellushe Veliraj

